



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Në bazë të nenit 15., 16.2, dhe 16.4.b., dhe 20, të Ligjit për Planifikim të Hapsirës nr. 2003/14, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 38.1. (b,c,d.) të dhe nenit 81. (h.i.) të Statutit të Komunës së Gjilanit,e në vështrim të pikës V. të Vendimit mbi miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-17735 të dt. 30.10/2008, dhe pikës 8 të Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban: "Fidanishte", Nr.01- 2749, të dt. 16.09/2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.05.2011, miraton këtë:

V E N D I M

Për qasjen e Plotësimit e Planit Rregullues Urban: " FIDANISHTE"

1.

Me këtë Vendim, i qaset plotësimit të Planit Rregullues Urban: "Fidanishte", të Qytetit të Gjilanit, Nr.01.2749, të dt. 16.09/2010, (në tekstin e mëtjemë: PRRU-"Fidanishte").

2.

Me plotësimet e PRRU nga pika 1. e këtij vendimi do të riplanifikohet zgjidhja urbanistiko-arqitektonike e hapësirës në kontekst të kërkesave të pronarëve për ndryshim destinimi si rezultat i procesit të privatizimit të pronave dhe partenriteit publiko-privat si dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale dhe të balancuara të zhvillimit, organizimit hapësinor dhe shfrytëzimit racional të hapësirës, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve banimore-afariste dhe destinime tjera si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës publike dhe infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional kësaj zone dhe inkorporimin e sajë si pjesë e tërësisë së Qytetit të Gjilanit.

3.

Plotësimet duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-17735 të dt. 30.10/2008, dhe duhet të inkorporohen si pjesë përbërse e PRRU: "Fidanishte", Nr.01.2749, të dt. 16.09/2010.

4.

Plotësimet e PRRU, nga pika 1. e këtij vendimi, duhet të përmbajën: Pjesën Tekstuale dhe Pjesën Grafike.

Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me Udhëzimit Administrativ për zbatimin e L.P.H. mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05 dhe detyra projektuese e hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

5.

Gjatë procesit plotësimit të këtij plani, veqmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese;
- organizimin e ndërtimeve të reja të destinimeve të përziera, përbrenda kufinjëve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke patur parasysh kushtet urbanistiko teknike dhe hapësinore si dhe mundësitë e harmonizimit të interesave publiko-private dhe patneritetin publiko-privat;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të asrimit, edukimit, shëndetsisë, mirëqenjes sociale, kulturës, sportit, administratës publike etj);
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse (rrugëve, gjelbrimit, public, hapsirave të lira, rrjeteve të ujësjellsit, kanalizimit fekal dhe atmosferik, rrjetit të përquesve elektrik, telekomunikes, etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe urbanistike të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm public.

6.

Hartues i procesit të plotësimit dhe harmonizimit të të këtij plani, do të jetë: NPN: "Favoring", me seli në Prishtinë.

7.

Bartës i Menagjimit të procesit të plotësimit dhe harmonizimit të këtij plani, caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ësGjilan.

8.

Draftdokumenti final- Projekti i këtij Plani, duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente.

9.

Koha dhe vendi për shqyrtim publik dhe dhënjën e komenteve duhet të duhet të shpallen në mjetet e informimit.

10.

Financimi i hartimit të plotësimeve të këtijë plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

Financimi mundë të bëhet edhe nga partneriteti publiko-privat, donatorët dhe komuniteti.

11.

Mbi zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani.

12.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

01.Nr. 16/7083
Gjilan, më 30.05.2011.

Kuvendi i Komunës,
Izmi ZEKA, Kryesues